



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Doretuar Punëno/Prodato Received/Delivered	21-06-2021	1	viti god year
Organ /Rjesia Organ /Jednitca Org /Unit	Hr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKOPSHTICK	3248/2021		1/1



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.404/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani-anëtar dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën e datës 11.05.2021 me numër A.nr.404/2021 të parashtruar nga ankuesit dhe të përfaqësuar nga avokat me adresë rruga: "Mramori", Hajvali/Prishtinë, kundër organit të punësimit/Komunës së Shtimes, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 21.06.2021, mori këtë:

### V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.404/2021 e datës 11.05.2021 e parashtruar nga ankuesit

### A r s y e t i m

Ankuesit dhe përmes përfaqësuesit të autorizuar më datë 11.05.2021, kanë parashtruar ankesë me Nr.protokolli 2318/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimet ankimore për kompensim të pagave jubilarë dhe shujtave ditore për vitin 2015, 2016, 2017 dhe 2018 sipas Kontratës Kolektive të Kosovës të vitit 2015.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 21.05.2021 ka dërguar kërkesën për

përgjigje në ankesë të ankuesit në Komunën e Shtimes. Më datë 01.06.2021 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Shtimes.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova:** Ankesën me Nr. Prot:2318/2021 të datës 11.05.2021 e parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimi i datës 16.09.2021 për Autorizimi për Autorizimi për

dhe Autorizimi për Përgjigje e datës 12.03.2021 në kërkesë nga Komisioni Komunal për Shqyrtimin e Ankesave për Nëpunësit Publikë për përfaqësuesin e ankuesve; Kërkesën për Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Shtimes e datës 06.04.2021 nga ankuesit; Listën e pagave e muajit korrik 2020 për ankuesin

Vërtetim nr.02/1nr.53 i datës 27.07.2020 për ankuesin Shkresë Emërimit nr.02/1nr.53/1 i datës 27.07.2020 për ankuesin Listën e pagave e muajit dhjetor nr.02/1/12 i datës 31.01.2011 për ankuesin

2018 për ankuesin Vërtetim nr.02/1nr.75 i datës 06.10.2020 për ankuesin Vërtetim nr.02/1nr.76 i datës 06.10.2020 për ankuesin Ndryshim dhe plotësim i Akt emërimit me numër 02/nr.110 i datës 13.03.2019; Listën e pagave e muajit dhjetor 2018 për ankuesin Vërtetim nr.02/1nr.74 i datës 06.10.2020 për ankuesin

Vërtetim nr.02/1nr.73 i datës 06.10.2020 për ankuesin Akt emërimi me numër 02/nr.10/13 i datës 17.01.2012 ,për Listën e pagave e muajit dhjetor 2018 për ankuesin Vërtetim nr.02/1nr.87 i datës 18.11.2020 për ankuesin

Vërtetim nr.02/1nr.88 i datës 18.11.2020 për ankuesin Shkresë Emërimit nr.02/1/12 i datës 31.01.2011 për ankuesin Përgjigjen në ankesë e datës 01.06.2021; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 21.05.202; Ndryshim dhe plotësim i Akt emërimit me numër 02/nr.470 i datës 05.09.2018, për

Përshkrimi i detyrave të punës i datës 05.09.2018 , për pozitën zyrtar për shërbime publike; Përshkrimi i detyrave të punës i datës 13.03.2019, për pozitën: Koordinator për Mbrojtje nga Diskriminimi; Përshkrimi i detyrave të punës i datës 28.02.2011, për pozitën Shef i sektorit dhe zyrtar për punë të përgjithshme juridike dhe udhëheqjen e ndërrimeve në operatin kadastral; Përshkrimi i detyrave të punës i datës 28.02.2011, për pozitën: ofiqar; E-mail i datës 24.05.2021, kërkesë për informacion, nga z për z.M. shkresën për përmirësimin e gabimit në aktin administrativ, i datës 24.05.2021 nga Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Shtimes për përfaqësuesin e e autorizuar për ankuesit; Përgjigje nr.02/1-192 në Kërkesat e nëpunësve civilë të parashtruara përmes avokatit z.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesve, është e **pabazuara, sepse:**

Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunë të Shtimes, përmes shkresës zyrtare për përmirësimin e gabimit teknik në aktin administrativ ka njoftuar që: *"në shkresën e lartcekur data figuron 12.03.2021, e njëjta përmirësohet në 23.04.2021...i autorizuar i nëpunësive, i cili ka parashtruar kërkesa më datë 06.04.2021 dhe në përgjegjësin lidhur me këto shkresa figuron data 12.03.2021 konstatojmë se është bërë gabim teknik, data lëshimit dhe hartimit të përgjigjes është*

23.04.3031, andaj duke u bazuar në legjislacionin në fuqi u përmirësuar gabimi i dukshëm në aktin administrativ”.

Ankuesit të punësuar në Komunën e Shtimes në pozita të nëpunësve civilë, përmes përfaqësuesit të autorizuar më datë 06.04.2021 kanë parashtruar kërkesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Shtimes, për kompensimin e pagave jubilarë dhe shujta ditore për ditët e pranisë në punë. Komisioni Komunal për Shqyrtimin e Ankesave për Nëpunësit Publike, më datë 23.04.2021 ka dhënë përgjigje tek përfaqësuesi i i autorizuar i ankuesve, duke e njoftuar se sipas Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nëpunësit civil paraqesin ankesë drejtpërdrejtë në KPMSHCK-së, për çdo veprim apo mosveprim që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil, sipas nenit 24 paragrafit 3 të këtij ligji.

Ankuesit në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përmes përfaqësuesit të tyre, pretendojnë që Komuna e Shtimes, nuk ka bërë kompensim të pagave jubilarë dhe shujtave ditore për vitin 2015, 2016, 2017 dhe 2018 sipas Kontratës Kolektive të Kosovës të vitit 2015.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar që Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës ka hyrë në fuqi më datë 01.01.2015 sipas nenit 82 të saj, ndërsa ka pasur një kohëzgjatje prej tri vitesh siç parashihet me dispozitat e nenit 90 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, përcaktohet që: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet”*, mirëpo neni 81 i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, respektivisht paragrafi 1 ka përcaktuar që: *“Nga MPKK, Palët mund të tërhiqen tre (3) muaj para skadimit të vlefshmërisë së saj, përmes letrës rekomanduese. Tërheqja nga kjo MPKK, shpallet në Gazetën Zyrtare të Kosovës”*, bazuar në këtë Oda Ekonomike e Kosovës si nënshkruese e kësaj marrëveshje më datë 15.09.2017 ka njoftuar Ministrin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale se për arsye ligjore tërhiqet nga zbatimi i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive. Neni 82 paragrafi 2 i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive e Kosovës përcakton se: *“Nëse nga MPKK, pasi që i skadon afati i përcaktuar, nuk tërhiqet asnjëra nga Palët, zbatimi i saj vazhdon edhe për një vit”*, me qenë se njëri nga nënshkruesit e kësaj marrëveshje është tërheq nga zbatimi i saj tre muaj para skadimit të të njëjtës, atëherë nuk vlen vazhdimi i kontratës edhe për një vite.

Në momentin kur ka filluar të zbatohet Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës, ka qenë i zbatueshëm Ligji Nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative, i cili ka përcaktuar edhe afatet ligjore për parashtrim të ankesës, siç e përcakton neni 130.1 pika b, se: *“Ankimi administrativ bëhet brenda 30 ditësh nga dita kur: akti është shpallur në bazë të dispozitave të këtij Ligji ose ligjeve të tjera në fuqi”*, kështu që Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës, ka qenë publike (e publikuar në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës), në këtë rast të gjithë të punësuarit kanë qenë të njoftuar me të drejtat që rrjedhin nga kjo Kontratë.

Bazuar në provat e lëndës ankuesit nuk kanë dëshmuar që në kohën sa ka qenë e zbatueshme Kontrata e Përgjithshme Kolektive e Kosovës, kanë parashtruar kërkesë apo ankesë në Komunën e Shtimes lidhur me pretendimet e tyre ankimore, ndërsa nëse i referohemi kërkesës së datë 06.04.2021 të parashtruar nga ankuesit në Komisionit për Zgjidhjen e



Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Shtimes, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vlerëson se ankuesit fillimin e ankimit e kanë bërë pas një kohe më shumë se tri (3) vite nga momenti kur Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës nuk është e zbatueshme në Republikën e Kosovës.

Gjithashtu, neni 125 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ka përcaktuar se: *"Përpos nëse është paraparë ndryshe me ligj, ankesa mund të parashtrohet kundër një akti administrativ apo ndaj mosveprimit të organit publik brenda afatit të përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative (në vijim: "heshtja administrative")", dhe mbi këtë bazë Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ankuesit lidhur me pretendimet ankimore të tyre, procesin e ankimit e kanë filluar, në kundërshtim me nenin 127 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: "Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ", kështu që pretendimet ankimore të ankuesve janë të pabazuara.*

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit si dhe në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.404/2021, datë 21.06.2021.

Zyle Millaku GOJNOVCI

*Zyle Millaku*  
Procesmbajtëse



**Vendimi i dorëzohet:**

- Përfaqësuesit të ankuesve Avokat;
- Kryetarit të Komunës së Shtimes;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Shtimes; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

